



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:106764

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05404852

PPP.nr.167/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbartimore të kreditorit ProCredit Bank, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: A.B.1. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, A.B.2. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt dhe I.B. nga Ferizaj, rr "...", për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori I.B., me datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit I.B., i ushtruar kundër urdhrin për përmbartim P.nr.51/20, të datës 13.03.2020, lëshuar nga përmbartuesit privat P.Xh. nga Gjilani, sa i përket shumës së borxhit prej 16,226.61 euro dhe **SHFUQIZOHET** urdhri për përmbartim P.nr.51/20, i datës 13.03.2020, për shumën e borxhit prej 16,226.61 euro.

II.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit I.B., i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.51/20, i datës 13.03.2020, sa i përket shumës së borxhi të përgjithshëm të mbetur prej 18,600.79 euro dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.51/20, i datës 13.03.202, vetëm për shumën e borxhit të përgjithshëm të mbetur prej 18,600.79 euro dhe për shpenzimet e procedurës së përmbartimit.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.51/20, të datës 13.03.2020, përmbartuesi privat P.Xh., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditori ProCredit Bank, kundër debitorëve: A.B.1., A.B.2. dhe

I.B., për detyrimin e debitorëve, për pagesën e borxhit në shumë prej 34,827.40 euro, duke i përfshirë edhe shpenzimet e procedurës së përmbarrimit, në bazë të marrëveshjeve të pengut, nr....., e datës 19.03.2015 dhe, e datës 31.03.2016, ose ndalimin në mjetet në para nga xhirollogaria e debitorëve dhe bartjen në xhirollogarinë bankare të debitorit ose sekuestrimin e pengut, kolateralit të lënë peng nga debitorët.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarrimit, debitori I.B., brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar.

Kreditori në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarrim P.nr.51/20, të datës 13.03.2020 dhe pretendimet në prapësim të debitorit I.B. si dhe thëniet e kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit dhe vlerësoj se prapësimi i debitorit I.B. është pjesërisht i bazuar.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarrim P.nr.51/20, i datës 13.03.2020, i lëshuar nga përmbarruesi privat P.Xh., është pjesërisht i ligjshëm dhe i rregullt, përkatësisht është i ligjshëm, sa i përket shumës së përgjithshme të borxhit prej 18,600.79 euro dhe për shpenzimet e procedurës së përmbarrimit, ndërsa nuk është i ligjshëm urdhri për përmbarrim sa i përket shumës së borxhit prej 16,226.61 euro.

Sa i përket pretendimeve të debitorit I.B. në prapësim se: urdhri përmbarrimor është i pabazuar dhe i paligjshëm për shkak se kreditori nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën ka dëshmuar se i ka njoftuar huamarrësin dhe bashkë huamarrësin për pagesën e borxhit në vlerë prej 34,827.40 euro dhe të njëjtëve i ka kërkuar që të përmbyllin marrëveshjen për huadhënie, gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse përmbarruesi privat në rastin konkret, me rastin e lejimit të përmbarrimit, gjegjësisht nxjerrjes së urdhrin për përmbarrim ka vepruar në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.7a, të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën e Përmbarrimit, në të cilën është përcaktuar se si dokument përmbarrimor konsiderohet edhe marrëveshja mbi pengun siç janë në këtë rast marrëveshjet mbi pengun nr....., e datës 19.03.2015 dhe, e datës 31.03.2016, të cilat siç konstatohet nga shkresat e lëndës, që të dyja janë të regjistruara në Zyrën për Regjistrim të Pengut. Përndryshe regjistrimi

i pengut sipas marrëveshjes së pengut është detyrim ligjor dhe pa regjistrim të pengut marrëveshja mbi pengun nuk mund të cilësohet si dokument përmbarues. Po ashtu, gjykata konstaton se debitorët kanë qenë të njoftuar me pasojat e mosrespektimit të afatit të kthimit të kredive, pas nënshkrimit të tyre nga debitorët dhe kreditori për shkak të rënies në vonesë të debitorëve ka ushtruar propozimin e tij për përmbarim tek përmbaruesi privat kompetent.

Po ashtu, pretendimi i debitorit në prapësim se në rast të mos mundësisë së pagesës nga ana e debitorit të parë dhe të dytë unë në cilësinë e dorëzanit jam personi i fundit si mundësi për realizimin e borxhit të pretenduar, *gjykata konsideron se në bazë të nenit 49, të LPP-së, është përcaktuar shprehimisht se si duhet të kryhet përmbarimi dhe në rastin konkret është detyrim i Përmbaruesit Privat që ta respektoj radhën e përmbarimit të caktuar nga kreditori, përkatësisht duke kërkuar përmbushjen e detyrimit së pari nga debitori A.B.1. dhe A.B.2. si kredi marrës. Për më tepër në nenin 49, të LPP-së është paraparë shprehimisht se: “Përmbarimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarimin apo urdhrin për përmbarim”.*

Gjykata me rastin e pranimit pjesërisht të prapësimit të debitorit I.B., sa i përket shumës së borxhit prej 16,226.61 euro dhe shfuqizimit të urdhrin për përmbarim për këtë shumë të borxhit dhe refuzimit të prapësimit sa i përket shumës së borxhit prej 18,600.79 dhe për shpenzimet e përmbarimit dhe mbetjes në fuqi të urdhrin sa i përket kësaj shume të përgjithshme të borxhit dhe për shpenzimet e përmbarimit, mori për bazë njoftimin e dërguar me shkrim nga kreditori me datën 05.07.2023, të cilës gjykata ja fali besimin e plotë, në bazë të cilës vërtetohet se shuma e mbetur e borxhit, detyrimit të debitorëve ndaj kreditorit është shuma e përgjithshme prej 18,600.79 euro.

Si përfundim, gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit I.B. në prapësim, thëniet e kreditorit në përgjigjen e ushtruar në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstaton se prapësimi i debitorit është i bazuar sa i përket shumës së borxhit prej 16,226.61 euro dhe për këtë pjesë të borxhit e pranoj prapësimin e debitorit I.B. dhe e shfuqizoj urdhrin për përmbarim, ndërsa nuk është i bazuar prapësimi sa i përket shumës së përgjithshme të borxhit prej 18,600.79 euro dhe për shpenzimet e përmbarimit dhe për këtë pjesë të borxhit të mbetur dhe për shpenzimet e përmbarimit vendosi që ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.167/20, më datë 04.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.